



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.3

17 janar

2011

P Ë R M B A J T J A

Vendim i KM
nr.10, datë 6.1.2011

Për ngritjen e grupeve të punës për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut e përmbytjet në qarqet Shkodër, Lezhë dhe Durrës.....

Faqe

13

VENDIM
Nr.10, datë 6.1.2011

PËR NGRITJEN E GRUPEVE TË PUNËS PËR EVIDENTIMIN DHE VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA RESHJET E SHIUT E PËRMBYTJET NË QARQET SHKODËR, LEZHË DHE DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e grupeve të punës për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e shiut e përmbytjet në qarqet e Shkodrës, Lezhës dhe të Durrësit.

2. Grupet e punës, sipas njësive të qeverisjes vendore të prekura nga përmbytja, të kenë në përbërje specialistë dhe ekspertë, të përcaktuar nga ministrinë, institucionet dhe njësitë e qeverisjes vendore, sipas kategorizimit dhe ndarjes së mëposhtme:

Kategoria I. Evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve në kategorinë “Objekte banimi”

a) Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve për kategorinë I, ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Enti Kombëtar i Banesave, Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, ALUIZNI) dhe njësia përkatëse e qeverisjes vendore, duke ngritur 20 grupe pune.

b) Grupi i punës drejtohet nga përfaqësuesi i Entit Kombëtar të Banesave, i cili bashkërendon punën në të gjithë procesin e vlerësimit e të përpunimit elektronik të materialeve.

c) Grupet e punës, të përcaktuara në shkronjën “a”, ngarkohen të evidentojnë dhe të vlerësojnë dëmet në anën ndërtimore të banesave, në orendi dhe pajisje elektroshtëpiake.

ç) Afati për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në objekte banimi nga grupet e mësipërme të jetë brenda 20 (njëzet) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Kategoria II. Evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve në ekonomi bujqësore, në blegtori, në objekte të prodhimit dhe të përpunimit agro-bujqësor, në makineri dhe pajisje, në rezervatet e rritjes së peshkut, në bimë dekorative, si dhe në objekte ndihmëse

a) Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve për kategorinë II, ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësia përkatëse e qeverisjes vendore, duke ngritur grupe pune për secilën njësi të qeverisjes vendore, me specialistë të fushave përkatëse nga ministrinë, institucionet publike, ekspertë privatë të licencuar të fushës, në përputhje me nevojat e procesit të evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve.

b) Afati për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në objektet dhe zërat e mësipërm nga grupet e ngritura të jetë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

c) Grupi i punës drejtohet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i cili bashkërendon punën në të gjithë procesin e vlerësimit dhe të përpunimit elektronik të materialeve.

Kategoria III. Evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve në objekte sociale e publike

a) Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve për kategorinë III, ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe institucionet e varësisë, duke ngritur grupe pune me specialistë të fushave përkatëse dhe në përputhje me nevojat e procesit të evidentimit e vlerësimit të dëmeve.

b) Afati për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në objektet e zërat e mësipërm nga grupet e ngritura të jetë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Kategoria IV. Evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve në biznese

a) Për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve për kategorinë IV, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Enti Kombëtar i Banesave) dhe njësia përkatëse e qeverisjes vendore (në rastin e biznesit të vogël), sipas vendndodhjes së biznesit.

b) Grupi i punës drejtohet nga përfaqësuesi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, i cili bashkërendon punën në të gjithë procesin e vlerësimit e të përpunimit elektronik të materialeve për biznesin.

c) Afati për evidentimin dhe vlerësimin e dëmeve në objekte banimi nga grupet e mësipërme të jetë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

ç) Për objektet e biznesit, vlerësimi i dëmeve në makineri, mallra e pajisje të dëmtuara të kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar pranë organeve tatimore dhe doganore. Për vlerësimin e dëmeve në pajisje të dëmtuara mund të përfshihen edhe ekspertë privatë të licencuar në fushën përkatëse.

d) Vlerësimi i dëmeve në anën ndërtimore të bizneseve bëhet nga Enti Kombëtar i Banesave, në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

3. Emrat e përfaqësuesve të ministrive dhe të institucioneve për grupet e punës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, t'u dërgohen, brenda 2 (dy) ditëve nga hyrja në fuqi e vendimit, Ministrisë së Brendshme (Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile) dhe Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

4. Procedurat e evidentimit, të vlerësimit të dëmeve, të vlerësimit financiar dhe të miratimit të dëmshpërblimit do të kryhen, si më poshtë vijon:

a) Evidentimi dhe vlerësimi i dëmeve, sipas kategorizimit të mësipërm, të bëhen sipas formularëve-tip, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

b) Ministria e Punëve Publike dhe Transportit (Enti Kombëtar i Banesave), Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave i dërgojnë zyrtarisht këshillit të qarkut përkatës formularët e plotësuar nga grupet e punës të evidentimit dhe vlerësimit të dëmeve, së bashku me listën emërore të kryefamiljarëve, si dhe të bizneseve të objekteve të dëmtuara, shoqëruar me certifikatën familjare, fotokopjen e dokumentit të identifikimit, si dhe vlerësimet përkatëse për çdo objekt.

c) Këshilli i qarkut përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve, të gjithë praktikën ia përcjell Ministrisë së Brendshme, e cila, gjithashtu, brenda 5 (pesë) ditëve paraqet në Këshillin e Ministrave për miratim, projektvendimin përkatës me vlerën e dëmeve të shkaktuara nga përmbytja, së bashku me listën emërore të kryefamiljarëve të dëmtuar/bizneseve, të detajuar për dëmet në objekte banimi, bujqësi e blegtori, ndërtesa me karakter bujqësor, në objekte të prodhimit e të përpunimit agrobujqësor, në makineri dhe pajisje, në rezervatet e rritjes së peshkut, në bimë dekorative, si dhe në objekte ndihmëse, sipas formularëve-tip.

ç) Pas vlerësimit të dëmeve për kategoritë I dhe II, në objektet e banimit, në objektet ndërtimore të biznesit, në ndërtimet me karakter bujqësor etj., llogaritja të bëhet me çmimet sipas zërave të punimeve të ndërtimit, miratuar për qytetet e Shkodrës, të Durrësit dhe të Lezhës, për vitin 2010, nga Enti Kombëtar i Banesave.

d) Për objektet e biznesit, vlerësimi i dëmeve në makineri, mallra e pajisje të dëmtuara të kryhet në përputhje me dokumentacionin e depozituar pranë organeve tatimore dhe doganore. Vlerësimi i dëmeve në pajisjet e dëmtuara mund të kryhet nga ekspertë privatë, të licencuar në fushën përkatëse.

dh) Vlerësimi për orenditë dhe pajisjet e dëmtuara të kryhet, si më poshtë vijon:

- Për grupin pajisje elektroshtëpiake, vlerësimi të bëhet në bazë të çmimit aktual të tregut, përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, dërguar zyrtarisht Entit Kombëtar të Banesave;

- Për grupin orendi e mobilie, të bëhet dëmshpërblimi në lekë, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë për frymë dhe jo më shumë se 300 000 (treqind mijë) lekë për familje.

e) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në të mbjella, në gjënë e gjallë, në serra diellore ose me ngrohje, në mekanikën bujqësore, në rezervate peshku e në bimët dekorative, të kryhet sipas çmimeve të tregut të marra nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Baza ushqimore të kompensohet nga shteti me një vendim të posaçëm të Këshillit të Ministrave.

ë) Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara në objekte social-publike (shkolla, spitale, qendra shëndetësore, kabina të tensionit të lartë, ujësjellës, hidrovorë, argjinatura) të kryhet nga specialistët e ministrive përkatëse, sipas çmimeve të marra nga ministrinë e linjës për sektorët e përmendur më lart.

Efektet financiare, që rrjedhin në këtë rast, të përballohen nga buxhetet përkatëse, miratuar për ministrinë e linjës.

5. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Shëndetësisë, prefektët e qarqeve Shkodër, Lezhë dhe Durrës, si dhe njësitë përkatëse të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

SITUACION VLERËSIMI (NDËRTESTA)

Emri, atësia, mbiemri _____
 Nr. i dokumentit të identifikimit _____
 Njësia vendore _____
 Vendbanimi, lagja _____ fshati _____

Banesa rezulton me dëmtime _____

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
	Shuma totale				

Vlerësimi bëhet me çmimet e miratuara të EKB për qytetin _____

KOMISIONI I VLERËSIMIT

Përfaqësuesi i MPPT (EKB & I NUK) _____

Përfaqësuesi i ALUIZNIT _____

Përfaqësuesi i komunës/bashkisë _____

SITUACION VLERËSIMI
(ORENDI E MOBILIE + PAJISJE ELEKTRO-SHTËPIAKE)

Emri, atësia, mbiemri _____
 Nr. i dokumentit të identifikimit _____
 Njësia vendore _____
 Vendbanimi, lagja _____, fshati _____
 Banesa rezulton me dëmtime _____

Nr.	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
	Shuma totale				

Vlerësimi bëhet me çmimet e konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

KOMISIONI I VLERËSIMIT
 Përfaqësuesi i MPPT (EKB & I NUK) _____
 Përfaqësuesi i ALUIZNIT _____
 Përfaqësuesi i komunës/bashkisë _____

MINISTRIA E BUJQËSISË USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT

FORMULAR NR.3

PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA PËRMBYTJET NË BUJQËSI

Emri, mbiemri i fermerit _____
 Fshati _____
 Komuna _____
 Qarku _____

I. Dëme të shkaktuara në kulturat bujqësore të arave

Nr.	Kulturat	Sipërfaqe e dëmtuar ha	Shkalla e dëmit në %ndaj sipërfaqes totale	Rendimenti kv/ha	Prodhimi i dëmtuar kv	Çmimi lekë/kv	Vlera e dëmit, gjithsej lekë
1	Grurë			40		3000	
2	Lakër kokë			320		2500	
3	Qepë e njomë			200		5000	
4	Presh			280		4000	
5	Sallatë (prodhim në serë)			200		10000	
6	Spinaq (prodhim në serë)			200		9000	
7	Jonxhë			400		600	
8	Foragjere të tjera (hasulla)			250		500	
9	Fasule			14.5		20000	
10	Jonxhë e re			150		500	
11	Misër			55		3300	
12	Patate			216		5700	
13	Bostan			280		3000	
14	Kastravec			240		5300	
15	Domate			250		6700	
16	Speca			180		5400	
17	Bishtajë			85		9400	
18	Spec (prodhim në serë)			450		18000	
19	Domate (prodhim në serë)			950		12000	
20	Patëllxhan (prodhim në serë)			280		20000	
21	Fidanë perimesh (në serë)	Fidanë				25 lekë/fidanë	
22	Tranguj (prodhim në serë)			960		16000	
	SHUMA I						

Shënim. Për prodhimin në sera, përlllogaritja bëhet si më poshtë:

- Kur bimët janë në prodhim të plotë, llogaritet 100 % e prodhimit.
- Kur bimët janë në fazën e sapombjelljes në fushë, vlera e dëmit llogaritet: vlera e fidanit 25 lekë/bimë +20 % e vlerës së prodhimit.
- Kur bimët janë në fazën e fillimit të lulëzimit, llogaritet 60 % e prodhimit.

II. Dëme të shkaktuara në pemë frutore, hardhi, ullinj

Nr.	Kultura	Njësia	Dëmtuar gjithsej, rrënjë	Vlera lekë/ rrënjë	Vlera lekë gjithsej
1	Pemë frutore të reja			4500	
2	Pemë frutore në prodhim të plotë			6000	
3	Ullinj të rinj			7800	
4	Ullinj në prodhim të plotë			12700	
5	Hardhi të reja			1250	
6	Hardhi në prodhim të plotë			1500	
7	Agrume të reja			5000	
8	Agrume në prodhim të plotë			6300	
9	Kivi në rritje			4600	
10	Kivi në prodhim			6000	
	SHUMA II				

Shënim. Diferencimi i pagesës në pemë frutore, ullinj, agrume dhe hardhi, të cilat nuk kanë hyrë akoma në prodhim, sipas moshës bëhet si më poshtë:

Pemë frutore dhe ullinj në rritje

1. Në moshën 1-vjeçare, 40 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II, pika 1 dhe 3;
2. Në moshën 2-vjeçare, 50 %;
3. Në moshën 3-vjeçare, 60 %;
4. Në moshën 4-vjeçare, 70 %;
5. Në moshën 5-vjeçare, 80 %;
6. Në moshën 6 vjeçare, 100 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II, pika 1 dhe 3.

Hardhi në rritje

1. Në moshën 1-vjeçare, 40 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II, pika 5;
2. Në moshën 2-vjeçare, 70 %;
3. Në moshën 3-vjeçare, 80 %;
4. Në moshën 4-vjeçare, 100 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II, pika 5.

Agrume në rritje

1. Në moshën 1-vjeçare, 60 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II pika 7;
2. Në moshën 2-vjeçare, 70 %;
3. Në moshën 3-vjeçare, 80 %;
4. Në moshën 4-vjeçare, 90 %;
5. Në moshën 5-vjeçare, 100 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II pika 7.

Kivi në rritje

1. Në moshën 1-vjeçare, 60 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II pika 9;
2. Në moshën 2-vjeçare, 80 %;
3. Në moshën 3-vjeçare, 90 %;
4. Në moshën 4-vjeçare, 100 % e vlerës së përcaktuar në tabelën II pika 9.

III. Dëme të shkaktuara në kafshët bujqësore

Nr.	Lloji kafshës (kategoria)	Njësia	Dëmtuar gjithsej	Nr. i matrikullit i gjedhit	Vlera për kokë (lekë)	Vlera e dëmit gjithsej (lekë)
1.	Lopë race				150 000	
2.	Lopë vendi				90 000	
3.	Mëshqerrë				110 000	
4.	Viça				40 000	
5.	Dele				13 000	
6.	Rrurëza (milore)				8 000	
7.	Qengja				2 500	
8.	Dhi				12 000	
9.	Ftuja				9 000	
10.	Keca				2 500	
11.	Dosa/harça				25 000	
12.	Derra				10 000	
13.	Gica 0 -3 muaj				4 000	
14.	Kalë				50 000	
15.	Pelë				65 000	
16.	Mushkë				45 000	
17.	Gomar				10 000	
18.	Mëz				10 000	
19.	Pula fushe				1 000	
20.	Pula deti				3 500	
21.	Shpendë uji				1 300	
22.	Zogj				100	
23.	Koshere blete				25 000	
	SHUMA III					

- Në fermat familjare numri i shpendëve që do të zhdëmtohen do të jetë maksimumi 20 krerë.
- Në komplekset e shpendëve do të merret për bazë numri i shpendëve të evidentuar me komision në momentin e dëmtimit (përmytjes).
- Për të gjitha kategoritë e tjera të kafshëve, do të zhdëmtohet vetëm numri i kafshëve të dëmtuara në fakt të evidentuara me komision nga strukturat e shërbimit veterinar të DRBUMK dhe komunës/bashkisë në momentin e përmytjes ose në momentin kur bëhet verifikimi dhe vlerësimi i dëmit.

IV. Dëme të shkaktuara në bazën ushqimore të blegtorisë

Nr.	Emërtimi	Njësia	Dëmtuar gjithsej	Vlera për njësi lekë	Vlera e dëmit gjithsej lekë
1	Koncentrate (ushqim i gatshëm)	kg		35	
2	Silazh misri kalli	kg		17	
3	Misër kokërr	kg		28	
4	Kashtë misri	kg		15	
5	Jonxhë e thatë	kg		25	
6	Bar i thatë livadhi	kg		20	
7	Kashtë gruri	kg		10	
	SHUMA IV				

1m³ misër kalli në koçek = 350 kg; 1 m³ silazh = 700 kg; 1 m³ kashtë misri = 30 kg;
1 m³ jonxhë e thatë = 70 kg; 1 m² bar i thatë = 60 kg; 1 m³ kashtë gruri = 40 kg.

V. Dëme të shkaktuara në ndërtesa me karakter bujqësor

Nr.	Emërtimi	Njësia	Dëmtuar gjithsej	Vlera për njësi lekë	Vlera e dëmit gjithsej lekë
1	Sera diellore	m ²		2500	
2	Sera me ngrohje	m ²		3500	
3	Hangar				
4	Stalla				
	SHUMA V				

Shënim. Vlerat e përcaktuara në tabelë për serat janë ato për sera të reja. Për serat e vjetra vlera e dëmit llogaritet si më poshtë:

- Serë në vitin e parë të përdorimit, llogaritet 100% e vlerës për m² të paraqitur në tabelën V.
- Serë e vitit të dytë të përdorimit, 80% e vlerës bazë për m².
- Serë e vitit të tretë të përdorimit, 70% e vlerës bazë për m².
- Serë e vitit të katërt të përdorimit, 60% e vlerës bazë për m².
- Serë e vitit të pestë e më shumë të përdorimit, 50% e vlerës bazë për m².

VI. Dëme të shkaktuara në makineri bujqësore

Nr.	Lloji i makinerisë	Marka	Vlera lekë i/e papërdorur	Përshkrimi i dëmit	Vlera për t'u zhdëmtuar lekë
1	Traktor 15-25 KF	Kinez	800 mijë		
	Traktor 25-50 KF	Kinez	1.3 milionë		
	Traktor mbi 50 KF	Kinez	2 milionë		
2	Traktor 15-20 KF	Italian	1.5 milionë		
	Traktor 25-50 KF	Italian	3.2 milionë		
	Traktor mbi 50 KF	Italian	5 milionë		
3	Traktor 15-20 KF	Gjerman/japonez etj.	1.7 milionë		
	Traktor 25-50 KF	Gjerman/japonez etj.	3.7 milionë		
	Traktor mbi 50 KF	Gjerman/japonez etj.	7 milionë		
4	Kultivator	Marka të ndryshme	600 mijë		
5	Makina mbjellëse	Marka të ndryshme	400 mijë		
6	Disqe	Marka të ndryshme	300 mijë		
7	Freza	Marka të ndryshme	600 mijë		
8	Pompa spërkatëse (të vogla)	Marka të ndryshme	70 mijë		
9	Pompa spërkatëse për traktor	Marka të ndryshme	350 mijë		
10	Makineri për mjelje në komplekse blegtorale	Marka të ndryshme	800 mijë		
11	Rimorkio transporti	Marka të ndryshme	400 mijë		
12	Autokombajna	Marka të ndryshme	10 milionë		

Shënim. Përlllogaritja e vlerës së mjetit, në rastin kur është i përdorur, bëhet:

1. Mjete me një vit pune: zbritet 10 % e vlerës fillestare të blerjes të pasqyruar në tabelën e mësipërme.

2. Mjete me 2-3 vjet pune: zbritet 15 % e vlerës fillestare.

3. Mjete me 4-5 vjet pune: zbritet 20 % e vlerës fillestare.

4. Mjete me mbi 5 vjet pune: zbritet 30 % e vlerës fillestare.

Nëse në një makineri është dëmtuar një pjesë e veçantë, p.sh. motori, gomat, kabina etj., atëherë vlera për t'u zhdëmtuar llogaritet: vlera e pjesës së dëmtuar duke zbritur nga 10-30% sipas kohës së përdorimit të mjetit.

VII. Dëme të shkaktuara në bimë dekorative

Nr.	Kultura	Njësia	Dëmtuar gjithsej rrënjë	Vlera lekë/rrënjë	Vlera lekë gjithsej
1	Bimë dekorative 1-2 vjeçare			300	
2	Bimë dekorative 3-4 vjeçare			400	
3	Bimë dekorative mbi 4-vjeçare			600	
	SHUMA VII				

VIII. Dëme të shkaktuara në rezervatet e rritjes së peshkut

Nr.	Emërtimi	Njësia	Dëmtuar gjithsej	Vlera lekë/njësi	Vlera lekë gjithsej
1					
2					
3					
	SHUMA VIII				

SHUMA I + II + III + IV + V + VI + VII + VIII _____

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1. _____ 2. _____ 3. _____
4. _____ 5. _____

Shënim. Përfaqësuesi i Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave do të marrë pjesë vetëm në rastin e vlerësimit të dëmeve në bimët dekorative dhe në rezervatet e rritjes së peshkut.

NDREQJE GABIMI

Në vendimin nr.852, datë 21.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.156, datë 26.11.2010, në faqen 8223, shkronja “ç” e pikës 8 të ndarjes II “Funksionimi i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentimit”,

Ishte:

ç) Të ketë titull ose gradë shkencore në administrim biznesi, menaxhim publik apo në të drejtën tregtare.

Bëhet:

ç) Është e preferueshme të ketë titull ose gradë shkencore në administrim biznesi, menaxhim publik apo në të drejtën tregtare.

Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.

Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 17.1.2011

Doli nga shtypi më 17.1.2011

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 16 lekë